

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKAT THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtarja e vetme gjykuese Vjollca Buzhala, me sekretarën juridike Drita Baftjari, në lëndën penale kundër të akuzuarit H Sh nga fshati B , Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6, lidhur me par. 1 të KP-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH -se, në Prizren, PP/II.nr.2246-5/17 të datës, 05.10.2017, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.11.2017, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari H Sh , nga i ati R dhe e ërna Z - e lindur S , i lindur me datë , në fshatin B , Komuna e Prishtinës, tani me banim në Prishtinë, rr. " " nr. , ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 18.08.2017, rreth orës 12:00 min, në rrugën P: R afër Masnastirit Ortodoks, i akuzuari duke e drejtuar automjetin e markës " Mercedes benz 220E" me targa LN57BBX, duke e shkelë ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR-së, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rethanava të rrugës, nuk e mban anën e djathtë të drejtimit por kalon në shiritin e kundërt të rrugës, ku dhe godet automjetin " Audi A3" me targa , me pjesë të përparme të anës së majtë, ku si pasojë e aksidentit përveç dëmeve materiale lëndime të lehta trupore merr vet i akuzuari H Sh M Sh ( bashkëshortja), si dhe të dëmtuarit A Gj N C , lëndime këto të përshkruara më përfaqësisht si në akt ekspertimin e mjeko-ligjor të ekspertit dr. D H , me numër të ref. PZ-747/17 të dt. 30.09.2017

Me këto veprime kryen veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.6, lidhur me par.1, të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

## U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti përgjithshëm, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor PP/II.nr.2246-5/17 të datës, 05.10.2017.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4,41,43 par.1 pika 1.3, nenit 46,73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par. 1, të KP-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit Hasan Shahini, ia shqipton:

## D E N I M I N M E G J O B Ë

Në lartësinë prej 200 € (dyqind ) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobe nuk realizohet as detyrimisht, atëherë gjykata konform nenit 46 par.3 të KP-së, dënimin me gjobë në lartësi prej 200 € do ta zëvendëson me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (djetë) ditësh, ashtu që për çdo 20 € nga dënimi me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Të dëmtuarit, A: Gj. ... dhe Nj C: ... që të dytë nga Prizreni, rr nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

I pandehuri obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë, paushallin gjyqësorë në shumën prej 20 €, ekspertiza mjeko – ligjore në shumën prej 20 €, ekspertiza e komunikacionit në shumë prej 40.88 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me nr. PP/II.nr.2246-5/17 të datës, 05.10.2017, kundër të pandehurit H Sh ..., për veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6, lidhur me par. 1 të KP-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se e pandehura e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.


Pas shqimit të shkresave të lëndës dhe provave dhe që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 p.1 të KPP-se, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë, Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit 2017-GR-0654 të datës 18.08.2017, raporti i oficerit me numër të rasti 2017-GR-0654, të datës 18.08.2017, deklarata e të akuzuarit H Sh ... e dhënë me NJRKRR në Prizren me datë 18.08.2017, deklarata e të dëmtuarit Arsim Gjashëgishiti të dhënë NJRKRR në Prizren më datë 18.08.2017, raporti mjekësor i Spitalit Rajonal "Emergjencia" për të dëmtuarin H Sh ... me numër të protokollit 9612 të datës 18.08.2017, raporti mjekësor i Spitalit Rajonal "Emergjencia" për të dëmtuarin M Sh ... me numër të protokollit 9613 të datës 18.08.2017, raporti mjekësor i Spitalit Rajonal "Emergjencia" për të dëmtuarin A G ... me numër të protokollit 9610 të datës 18.08.2017, raporti mjekësor i Spitalit Rajonal "Emergjencia" për të dëmtuarin Nj C: ... me numër të protokollit 9611 të datës 18.08.2017; kt ekspertimi i ekspertit të komunikacionit rrugor Ingj. S Sh ... të datës 27.09.2017, akt ekspertimin e mjekoligjor të ekspertit doktor D H ... me numër të referencës Pz-747/17, të datës 30.09.2017, si dhe dokumentacioni në shkresa të tjera të lëndës, u vërtetua se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë veprë penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marr në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPP-së.




Me sa u tha me larte, ne kuptim te nenit 365 te KPP-se, u vendos si ne diapozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
P.nr.1906/2017, me datë 20.11.2017

Sekretarjajuridike  
Drita Bafjari



Gjykatësja,  
Vjollca Buzhala



**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër ketij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në gjykatën Themelore në Prizren. Po qese i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.